

24 shkurt 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe sipas Informatorit Nr.9/2025-26 Liga U16 Djemtë për iniciimin e procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor i FBK-së ("KD"), me datë 24.02.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET vërejtje ndaj z. Ramush Rushiti dhe z. Qazim Rushiti (KB Junior 06) për shkelje të lehtë disiplinore sipas Nenit 48(2)(b) të Rregullores Disiplinore të FBK-së;
- II. Masa ka efekt ndalues për çdo sjellje të ngjashme që mund të cenojë rregullin dhe respektin në kuadër të aktiviteteve sportive të organizuara nga FBK;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Më datë 18.02.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së ("KD"), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore përmes Informatorit Nr. 9/2025-26 të Ligës U16 Djemtë (tash e tutje "Kërkesa"), e cila ka të bëjë me supozimin për shkelje të lehtë lidhur me garat, nga zyrtarët e Junior 06, z. Ramush Rushiti dhe z. Qazim Rushiti, në ndeshjen e zhvilluar me datë 14 shkurt 2026, ndërmjet KB Junior 06 dhe PC Prizreni.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 19.02.2026, në orën 17:00, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç' rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, KD, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet administratës së FBK-së, t'i kërkohet deklaratë me shkrim palës ndaj të cilit është iniciuar procedura.

Më datën 23.02.2026, KD, nëpërmjet email-it, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratën nga zyrtarët e Junior 06.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 19.02.2026, KD ka mbajtur takim edhe me datë 23.02.2026, ku ka shqyrtuar deklaratën me shkrim dhe provat e tjera të administruara nga sekretaria. Gjatë shqyrtimit, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

KD potencon se dispozita përkatëse që trajton këtë rast është Neni 48, alineja 2, pika b) i Rregullores Disiplinore i cili thotë:

2. Shkelje të lehta në lidhje me garat, dhunën dhe dukuritë e tjera negative në sport konsiderohen këto si në vijim:

[...]

(b) Ofendimi ose veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj një anëtari të ekipit, një tjetër individ, publiku, apo çdo person tjetër, e që nuk përbën një shkelje të rëndë.


Komisioni Disiplinor ka konstatuar se gjatë ndeshjes së zhvilluar nga KB Junior 06, palët kanë shfaqur veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj personave zyrtarë të ndeshjes. Palët kanë pranuar fajin dhe kanë shprehur keqardhje për veprimet e kryera. Nga shqyrtimi i ngjarjes ka rezultuar se rrethanat e veprimit nuk përbëjnë elemente rënduese: ngjarja nuk ka ndikuar në rezultatin apo rrjedhën normale të lojës, nuk ka pasur dhunë fizike dhe nuk ka shkaktuar pasoja për individët e përfshirë.

KD thekson se ofendimi i supozuar përbën shkelje të lehtë sipas Nenit 48(2)(b) të Rregullores Disiplinore, i cili sanksionon veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj personave zyrtarë të ndeshjes, pa përbërë shkelje të rëndë. Rrjedhimisht, sipas Nenit 49(1.2) të Rregullores Disiplinore, për shkelje të tilla të lehta, masa e përshtatshme është vërejtja.

Duke marrë parasysh precedentët e mëparshëm të Komisionit, pranimin e fajit nga palët, rrethanat lehtësuese të veprimit dhe parimin e proporcionalitetit, KD ka vendosur se shqiptimi i vërejtjes është masa më e drejtë dhe e përshtatshme për të dërguar një mesazh të qartë se veprimet që tregojnë mungesë respekti nuk tolerohen në sportin e basketbollit.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, KD vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 24 shkurt 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Junior 06, gjegjësisht z. Ramush Rushiti dhe z. Qazim Rushiti
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.